

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: AGJENCIA PYJORE E KOSOVES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	203/40300-26-1677-2-6-10
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan, DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj, dhe Blinajë - Lot 9 – Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik”

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU”

Prishtine

PRISHTINË

10000

+383 44440261

Bedri Murtezi



Murtezi.bedri@gmail.com

27.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Aktiviteti i prokurimit “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan ,DR-Mitrovicë ,DR-Ferizaj , dhe Blinajë” është publikuar me datë **31.03.2026 në eprokurim.**

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë 20.04.2026 në ora 14:00.

Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më i lartë

B58 Njoftim mbi vendimin e ak se bashku me letrat standarde te tenderuesve, datë 08.06.2026

Kërkesa për rishqyrtim, datë 12.06.2026

Vendimi i AK “Hudhet e pa lejuar kërkesa për rishqyrtim” datë 18.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP dhe RRPP për mostrajtimin e kërkesës për rishqyrtim janë:

- Neni 61 Pezullimi I aktivitetit të prokurimit, i RRPP; dhe
- Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Ndërsa gjatë procesimit të aktivitetit të prokurimit, AK Agjencia Pyjore e Kosoves nuk e ka respektuar Ligjin për Prokurimi Publik dhe Rregulloren për Prokurim Publik në nenet në vijim:

- Neni 1 – Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik
- Neni 2 – Parimet e përgjithshme të prokurimit
- Neni 6 – Ekonomizimi dhe efikasiteti (vlera për paranë publike)
- Neni 7 – Trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues
- Neni 56 – Vlerësimi i tenderëve
- Neni 59 – Përgjegjësia dhe ligjshmëria e vlerësimit
- Neni 65 – Përcaktimi i tenderuesit të përgjegjshëm

Neni 71 – Ndërlidhja / konflikt interesi (interpretimi i pretenduar nga AK)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesë ndaj vendimit të AK për hudhjen e kërkesës për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan, DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj, dhe Blinajë - Lot 9 – Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik”

Ne GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU” parashtrojmë këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për hudhjen e kërkesës për rishqyrtim si të papranueshme, duke e konsideruar të njëjtin vendim si të pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurim Publik në fuqi. Kjo ankesë ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave tona procedurale dhe materiale të garantuara me legjislacionin në fuqi, si dhe sigurimin e trajtimit të drejtë, të barabartë dhe ligjor të kërkesës për rishqyrtim.

Fillimisht ju informojmë se për shkak të një gabimi teknik në platformën e-prokurimit, kërkesa për rishqyrtim nuk është trajtuar nga Autoriteti Kontraktues – Agjencia Pyjore e Kosovës (APK). Konkretisht, kërkesa jonë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me Pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan, DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj dhe Blinajë”, me nr. 203/40300-26-1677-2-6-10, është ngarkuar gabimisht në një aktivitet tjetër të prokurimit, ndonëse përmbajtja dhe objekti i saj i referohen qartë dhe në mënyrë të padiskutueshme aktivitetit të prokurimit “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me Pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan, DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj dhe Blinajë”, me nr. 203/40300-26-1677-2-6-10.

Në këtë rast, sipas Rregullores për Prokurim Publik (RRPP), neni 61 paragrafi 2, si dhe neni 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, paragrafi 5, Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrim ligjor që në rast të ndonjë mungese formale apo teknike në kërkesën për rishqyrtim, t’i kërkojë palës parashtuese plotësimin apo korrigjimin e saj brenda afatit ligjor prej dy (2) ditësh. Në mënyrë plotësuese, neni 108/A i LPP-së dhe veçanërisht paragrafi 5 përcakton shprehimisht se nëse aplikimi nuk përmban informacionet e kërkuara, autoriteti kontraktues është i obliguar të kërkojë nga ankuesi plotësimin e kërkesës brenda afatit prej dy (2) ditësh nga pranimi i saj. Këto dispozita kanë karakter detyrues dhe garantojnë të drejtën e palës për mjet juridik efektiv dhe trajtim meritot të kërkesës, duke përjashtuar refuzimin apo mos-trajtimin për shkaqe formale pa mundësi korrigjimi.

Mosveprimi i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në drejtim të zbatimit të këtyre dispozitave përbën shkelje të drejtpërdrejtë të RRPP-së dhe Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe cenon parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë transparencën, trajtimin e barabartë dhe proporcionalitetin. Rrjedhimisht, është cenuar e drejta jonë për mjet juridik efektiv dhe për shqyrtim të rregullt administrativ të kërkesës për rishqyrtim.

Andaj, duke u bazuar në shkeljet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të merr këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** e bazuar ankesa e GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU”;

- II. ANULOHET** vendimi i AK Agjencioni Pyjor i Kosovës “Hudhet e pa lejuar kërkesa për rishqyrtim” GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU”;
- III.** Konstatohet moszbatimin e nenit 61 paragrafi 2 të RRPP dhe nenit 108/A paragrafi 5 të LPP nga ana e AK APK, për shkak të mungesës së kërkesës nga APK për plotësim/korrigjim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e Operatorit Ekonomik N.T.SH. “NAZI TRAVEL”; dhe
- IV. TË OBLIGOHET AK APK** të trajtoj kërkesën për rishqyrtim në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore në fuqi.

Në vijim është paraqitur përmbajtja e kërkesës për rishqyrtim e paraqitur në Agjencinë Pyjor të Kosovës me datë 12.06.2026 për “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan, DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj, dhe Blinajë - Lot 9 – Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik”

Autoriteti Kontraktues Agjencioni Pyjor i Kosovës ka publikuar njoftimin Ftesë për ofertim për shitje me emërtim “Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj, DR-Gjilan dhe Blinajë” me nr. të prokurimit 203/40300-26-1677-2-6-10.

Ofertat i kanë dorëzuar OE si:

Nr.	Tenderuesi (Operatorët Ekonomikë) & Lokacioni	Kodi i tenderit	Pjesa / Loti (Sipas PMP 2026)	Çmimi (€)	Çmimi me TVSh (€)
1	N.P. "Urani Com", Ferizaj	19042026/1	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj	39,303.63	46,378.28
2	Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. "... " / N.P.T. "Meti Comerc", Hani i Elezit	2004/2026-1	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj Hani i Elezit	27,971.89	33,006.83
3	"Pylla" SH.P.K., Velekincë, Gjilan	Pylla 2626 apk	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Gjilan Kamenicë	113,795.45	134,277.00
4	"Pylla" SH.P.K., Velekincë, Gjilan	Pylla 2626 apk	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin	33,912.53	40,016.30

			2026 në DR- Mitrovicë, Zubin Potok		
5	"Pylla" SH.P.K., Velekincë, Gjilan	Pylla 2626 apk	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në Blinajë	49,750.60	58,705.00
6	Grup i Operatorëve Ekonomik EURO - MODEL; PERSPEKTIVA V SH.P.K., Shillovë, 60000 Gjilan	APK-001-26	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan Kamenicë	91,657.14	108,155.43
7	Grup i Operatorëve Ekonomik EURO - MODEL; PERSPEKTIVA V SH.P.K., Shillovë, 60000 Gjilan	APK-001-26	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan	23,757.75	28,034.14
8	NTSH „Dardani“ , Korbuliq, 71000 Kaçanik	01/2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan Kamenicë	131,766.14	131,766.14
9	NTSH „Dardani“ , Korbuliq, 71000 Kaçanik	01/2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan	22,077.37	22,077.37
10	NTSH „Dardani“ , Korbuliq, 71000 Kaçanik	01/2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në Blinajë	54,582.21	54,582.21
11	NTSH „Dardani“ , Korbuliq, 71000 Kaçanik	01/2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik	94,301.22	94,301.22

12	Afërdita Kqiku B.I. , Gjilan 61000 Gjilan	APK - 20.04.2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan	32,262.27	38,069.48
13	Afërdita Kqiku B.I. , Gjilan 61000 Gjilan	APK-20.04.2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Hani i Elezit	41,229.80	48,651.16
14	GOE BERVENIKU CORPORATION SH.P.K. & N.T.SH. „BEDI COM“ , Prishtinë	203/40300-26- 1677-2-6-10	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në Blinajë	57,030.84	67,296.39
15	GOE N.T.SH. NAZI TRAVEL & Avni Murtezi B.I. , Prishtinë	203/40300-26- 1677-2-6-10	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në Blinajë	67,825.68	80,034.33
16	GOE N.T.SH. NAZI TRAVEL & Avni Murtezi B.I. , Prishtinë	203/40300-26- 1677-2-6-10	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik	138,934.18	163,942.33
17	Rabit Latifi B.I. , Ramiz Cërnica, Nr. 15 60000 Gjilan	APK - 20.04.2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan, Kamenicë	132,586.97	156,452.63
18	Rabit Latifi B.I. , Ramiz Cërnica, Nr. 15 60000 Gjilan	APK-20.04.2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR- Gjilan	18,431.86	21,749.60
19	Rabit Latifi B.I. , Ramiz Cërnica, Nr. 15 60000 Gjilan	APK - 20.04.2026	Shitja e masës drusore sipas Planit	99,210.36	117,068.23

Bazuar në Dokumentin B58 – “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” dhe në letrat standarde të tenderuesve, GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU” është eliminuar me një interpretimi të pasaktë dhe juridikisht të pambështetur në nenit 71 të LPP-së dhe nenet 26.11 dhe 26.12 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Eliminimi i GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU” është arsyetuar me pretendime të pabazuar për “ndërlidhje” të operatorëve përmes pronësisë dhe aksionarëve, pa ofruar asnjë provë konkrete për shkelje të dispozitave ligjore të LPP dhe legjislacionit sekondar.

Se eliminimi i GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU” është bërë në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe legjislacionit sekondar e konfirmon edhe interpretimin zyrtar të KRPP-së me nr. 2014, të datës 21/05/2026, i cili saktëson kufijtë e zbatimit të nenit 71 të LPP-së dhe e bën të qartë se lidhja pronësore nuk përbën vetvetiu bazë për përjashtim pa prova të ofertimit të shumëfishtë apo shkeljes reale.

Prandaj vendimi i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për eliminimin e GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU”, përbën shkelje të rëndë të parimeve të prokurimit publik për këto arsye:

- Më procesverbalin e hapjes së ofertave dëshmohet se **asnjëri nga OE anëtar të GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU” nuk kanë paraqitur ofertë tjetër individuale, dhe as si anëtar i ndonjë grupi tjetër në këtë aktivitet të prokurimit.** Rrjedhimisht, nuk ekziston asnjë rast i pjesëmarrjes së dyfishtë apo i ofertimit të shumëfishtë nga OE anëtarët e këtij grupi në këtë procedurë.
- **Zbatim arbitrar dhe i pabazuar në prova i dispozitave ligjore**, pasi Zyrtarja Përgjegjëse e Prokurimit, në kundërshtim me ligjin dhe interpretimin ligjor nga KRPP me nr. 2014 të datës 21/05/2026, **ka supozuar** lidhje ndërmjet aksionarëve dhe pronarëve të operatorëve ekonomikë. Ndërkohë, Ligji për Prokurimin Publik përcakton qartë se përjashtimi mund të bëhet vetëm në rast të pjesëmarrjes së dyfishtë ose shkeljeve të verifikueshme nga operatorët ekonomik. Citim i **nenit 71 “Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik”**, paragrafi 2: “Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit”.
- Po ashtu, RRPP, **neni 26 “Grup i Operatorëve Ekonomik”**, paragrafi 11, thotë: “OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit”, duke e qartësuar edhe më shumë se OE nuk ka të drejtë të dorëzojë tender si individ dhe si anëtar i grupit. Pra, asnjë dispozitë e LPP dhe e RRPP nuk e përcakton kufizimin e aplikimit në tender për pronarët dhe aksionarët e OE.
- Me këtë vendim, Zyrtarja Përgjegjëse e Prokurimit, me dashje dhe paramendim, ka bërë interpretim të gabuar të dispozitave ligjore të LPP, me ç’rast ka dëmtuar konkurrencën dhe vetë autoritetin kontraktues – Agjencionin Pyjor të Kosovës – duke e propozuar për kontratë të shitjes OE që është vetëm me çmim më të ulët.

- **Shkelje të rëndë të parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës**, duke cenuar drejtpërdrejt:
 - **Parimin e barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë (OE)**, pasi është bërë diskriminim i paarsyeshëm dhe i pabazuar në ligj ndërmjet tyre;
 - **Parimin e transparencës**, duke u bazuar në supozime dhe jo në prova të verifikueshme, gjë që e bën procesin jo të qartë dhe jo transparent;
 - **Parimin e proporcionalitetit**, sepse arsyeja për eliminim nuk ka bazë ligjore dhe tejkalon kufijtë e përcaktuar nga LPP dhe RRPP;
 - **Parimin e konkurrencës së lirë**, duke eliminuar padrejtësisht operatorë ekonomikë nga gara dhe duke dëmtuar interesin e autoritetit kontraktues.

Për më tepër interpretimi i bërë nga Zyrtarja Përgjegjëse e Prokurimit është **arbitrar, i pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me interpretimin zyrtar të KRPP**, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta në cenimin e konkurrencës dhe në dëmtimin e autoritetit kontraktues – Agjencionit Pyjor të Kosovës.

- **Dëmtim financiar të autoritetit kontraktues** duke qenë se ky është një aktivitet i tipit "Shitje" dhe GOE N.T.SH. "NAZI TRAVEL" DHE N.T.SH. "BERVENIKU" ka ofertuar më cmimin më të lartë për Lot 9. Duke eliminuar GOE N.T.SH. "NAZI TRAVEL" DHE N.T.SH. "BERVENIKU", është cenuar qëllimi kryesor i LPP-së për sigurimin e vlerës më të mirë për shitjen e pasurisë publike.
- **Anashkalim i kriterit për dhënie të kontratës**, pasi ky aktivitet prokurimi është i llojit "Shitje" (ankand/gjenerim i të hyrave për Autoritetin Kontraktues). Në këtë lloj procedure, ndryshe nga prokurimet për blerje, çmimi më i lartë i përgjegjshëm përbën kriterin kryesor për përzgjedhjen e fituesit, me qëllim maksimizimin e të hyrave dhe vlerës së pasurisë publike. Rrjedhimisht, eliminimi i një oferte me çmimin më të lartë të përgjegjshëm përbën shkelje të këtij kriteri dhe zbatim të gabuar të parimit të vlerësimit në procedurë.

Pra, nga analizimi i plotë i procesverbalit të hapjes së ofertave, vërtetohet se GOE N.T.SH. "NAZI TRAVEL" DHE N.T.SH. "BERVENIKU" ka dorëzuar vetëm një ofertë të vetme në këtë aktivitet prokurimi, specifikisht për Lotin 6 (Blinajë) me çmimin e tenderit prej 67,296.39 EUR me TVSh. Ofertat e dorëzuar për **Lot 9 – Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik, janë:**

Nr.	Tenderuesi (Operatorët Ekonomikë)	Kodi i tenderit	Pjesa / Loti	Çmimi (€)	Çmimi me TVSh (€)
11	NTSH „Dardani“, Korbuliq, 71000 Kaçanik	01/2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik	94,301.22	94,301.22
16	GOE N.T.SH. NAZI TRAVEL & Avni Murtezi B.I., Prishtinë	203/40300-26-1677-2-6-10	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin	138,934.18	163,942.33

			2026 në DP Ferizaj, Kaçanik		
19	Rabit Latifi B.I., Ramiz Cërnica, Nr. 15 60000 Gjilan	APK - 20.04.2026	Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DP Ferizaj, Kaçanik	99,210.36	117,068.23

Sipas Dokumentin B58 – “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, OE i propozuar për kontratë për Lot 9 është NTSH .., "Dardani " Korbulliq, 71000, Kaçanik me çmim të ofertës 54,582.21 € dhe është eliminuar GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU” duke shkaktuar **69,641.11 €** humbje direkte për AK.

Duke e parë qartë së në të kaluarën janë favorizuar operator ekonomikë të caktuar, në shitjet e ngastrave të caktuara, të cilët OE edhe me dokumentin e fundit B58 – “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” janë propozuar për kontratë edhe pse kanë dhënë oferta të blerjes së ngastrave me cmime më të ulëta, ky veprim jo vetëm që bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, por edhe ngre dyshime serioze për konflikt të pastër interesi ndërmjet Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit dhe operatorëve të favorizuar.

Në tabelën e paraqitur në dokumentin B58 – “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, mungojnë të dhënat për ofertën e NTSH “Dardani”, Korbulliq, 71000 Kaçanik, për lotin 9 dhe kjo mungesë nuk mund të konsiderohet si lëshim i thjeshtë teknik. por tregues i një **manipulimi të vazhdueshëm dhe të qëllimshëm**, i cili synon të c’orientoj rezultatin e prokurimit në favor të operatorëve të caktuar.

Bazuar në argumentet e pasqyruara më larte konsiderojmë se B58 “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, prandaj kërkojmë nga AK Agjencioni Pyjor i Kosovës, që të nxirret ky:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e GOE N.T.SH. “NAZI TRAVEL” DHE N.T.SH. “BERVENIKU”;

II. ANULOHET vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e GOE ankues; dhe

III. Lënda kthehet në rivlerësim, ku të gjitha ofertat (përfshirë ato me çmim më të lartë) do të ekzaminohen ekskluzivisht mbi bazën e plotësimit të kriterëve dhe dispozitave të LPP, duke u siguruar që masa drusore t’i shitet ofertuesit që ofron përfitimin më të madh financiar për AK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Diskualifikimi i një operatori ekonomik nga procedura e prokurimit për shkak të mungesës së përmbushjes së kriterëve të përzgjedhjes, të cilat nuk janë proporcionale me objektin e kontratës, shkakton dëme materiale të drejtpërdrejta për OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit.

Këto dëme materiale lidhen kryesisht me:

- humbjen e fitimit të pritur nga kontrata;
- shpenzimet e pakthyeshme të ofertimit; dhe

- humbjen e mundësive për kontrata të ardhshme, si pasojë e përjashtimit nga konkurrenca për një kriter që nuk reflekton domosdoshmërisht aftësinë reale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*